



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 88-të, të mbajtur më 16.06.2023, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Denoncimi I regjistruar me numër 12-7396/1 datë 27.07.2022 me pretendime për pakënaqësi në -----, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim kompetent sepse pretendimet në denoncimin e dorëzuar i referohen personit të panjohur dhe nuk ka të dhëna nëse i njëjti person ka qenë i punësuar në organin e njoftuar dhe as nuk ka aktivitete për të cilat KSHPK-ja ka kompetencë.

Lënda me numër 12-7396/1 të datës 27.07.2022 të mbyllet dhe arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së- brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

### Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur, -----, më datë 27.07.2022 është dorëzuar denoncim për pakënaqësi në veprimin e punonjësve të punësuar në ----- dhe është formuar lënda pas fatkeqësisë në komunikacion ku është lënduar parashtruesi i denoncimit.

Në rastin në fjalë, sipas pretendimeve, bëhet fjalë për një aksident të ndodhur më datë 11.02.2022 në një vendkalim për këmbësorë të pajisur me semafor në lagjen "----- në të cilën parashtruesi ka marrë pjesë në kallëzim si këmbësor dhe në të cilin është goditur nga automjeti i pasagjerëve. Ngjarja është evidentuar nga MPB-ja e cila ka kryer këqyrjen e vendit të aksidentit dhe më 5 korrik 2022 nga me postë të rekomanduar, parashtruesi i kërkesës ka pranuar thirrje nga -----, që të lajmërohet më 19.07.2022 në ora 10:00, e nënshkruar nga prokurori publik ----- Pas marrjes së ftesës parashtruesi ka telefonuar/ardhur në prokurori dhe gjykatë, por nuk është i kënaqur me sjelljen e personave që e kanë takuar aty dhe i janë drejtuar, dyshon në veprimet e tyre sepse. ai nuk e di se në çfarë cilësie i janë drejtuar.

Gjatë shqyrtimit të ankesës në fjalë, KSHPK-ja thekson se pretendimet në ankesë janë të paqarta, nuk i drejtohen një personi të caktuar dhe nëse ai është punonjës i gjykatës/prokurorisë dhe as nga veprimet e tij nuk rezulton në veprime të gabuara. Nga aty KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar: Parashtruesi i denoncimit  
Përgatiti: J.C.  
Miratoi: K.N.,anëtar i KSHPK-së

КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОР  
ПЉР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ  
Нѐнкрyетар  
Катика Николoвска

